

QASJE RELIGJIOZE RELIGJIONIT

Prof. Dr. Metin Izeti

“I dashur dije që njeriu nuk është i krijuar për argëtim ose rastësisht, por është krijuar i përsosur dhe për një qëllim të lartë”.

GAZALI¹

Situata religjioze në botën e sotit karakterizohet me dy pika ekstremisht të kundërta me njëra tjetrën: nga njëra anë radikalizmi dhe fanatizmi luftarak- që nuk e ka për dert edhe vrasjen e njerëzve të pafajshëm në rrugë po edhe nëse i takojnë religjionit të njëjtë, ndërsa nga ana tjetër neglizhenca fetare si dhe besimi sinkretist herë pas here i stolisur me ezoterizmin dhe okultizmin misterioz. Njeriu bashkëkohor gjithnjë e më tepër është i okupuar me vetveten dhe me fatin personal. Ai fatit të vet personal ia nënshtron edhe obligimet shoqërore dhe solidaritetin e bashkësisë. Me kalimin e ditëve ai shndërohet në narcis të vetmuar. Njeriu me modernën dhe postmodernën i përjetoi dy parime liberaliste: individualizmin dhe pluralizmin, të cilat deshtën ose jo u inkuadruan edhe në sendërtimin e idesë religjioze. Secili që mer guximin të hudhet të analizojë ngjarjet fetare do të ballafaqohet me një katrahurë të autoritarizmit dhe individualizmit brenda pluralitetit si religjioz ashtu edhe fraksional dhe grupor. Për arsye se religjioni në të shumtën e rasteve u bë maskë e qëndrimeve dhe lëvizjeve joreligjioze. Lëvizjet joreligjioze i hasim edhe në përditshmërinë në trajtë të radikalizmit ose okultizmit, por i hasim edhe në njohjen e të vërtetës religjioze dhe qasjes ndaj të vërtetave të besimit dhe ortopraktikës fetare. Qasjet shkencore-teknologjike nga njëra anë dhe ato mitologjike tradicionale nga ana tjetër religjionit ia humbën ndiesinë dhe aktualitetin kohor dhe hapësinor. Vlera e analizave joreligjioze ndaj religjionit është relative dhe e kushtëzuar për shkak se religjioni mund të kuptohet vetëm nëpërmjet religjiozes dhe religjionit. Në hulumtimin fetar subjekti dhe objekti duhet të jenë religjioze, që d.t.th. se subjekti duhet ta përjetojë fetaren.

¹ Gazali, Ebu Hamid, *The Alchemy of Happiness*, Lahor, 1964, f.17.

Subjekti që nuk është fetar e vret, e mbyt objektin religjioz të cilin e hulumton. Diskutimet apologjetike dhe juridike të fesë që moti janë shndëruar në diciplina të vdekura që përjetohen si përkujtime të mundimshme të religjiozitetit të dikurshëm.

Çka është esenca e religjionit, cili është nervi bazë i tij dhe pse kemi nevojë për te? Feja ose religjioni nuk është dije abstrakte, përkundrazi ai është gnozë, është koncept i tërësishëm konkret dhe organik i i jetës personale dhe botës përreth. Tradita konstituive e Islamit religjionin e konsideron si dhuratë hyjnore mbinatyrore, mirëqenëse, të lirë dhe jo të huazuar. Është mbinatyrore për shkak se burimin e ka në Zotin; është mirëqenëse për shkak se vjen si rezultat i mëshirës hyjnore që ka për qëllim vendosjen e alenacës me njeriun si krijesë kurorë e kreativitetit hyjnor; është i lirë për shkak se rrjedh prej lirisë së pakufishme të Zotit dhe është jo e huazuar për shkak se nuk jepet me pretendim ose me qëllim që ti kthehet por që me butësi të ngjallë besnikërinë, mirësinë dhe dashurinë ndaj Zotit.² Ajeti kuranor që flet për ekskluzivitetin e pranueshmërisë fetare para Zotit e karakterizon atë si nënshtrim absolut ndaj të Madhit, apo si përjetim i lirisë në skllëverinë e epiqendrës së qenësisë.³ Ka të drejtë Dostojevski kur thotë se, *unë jam realist dhe objektivist i cili qëndron në shenjë të kalimit drejtë universalizmit religjioz brenda hapësirës së përbotshme historike*.⁴ Ai e pranon traditën perenniale fetare, që për te, është i prezentuar në institucionalizimin e fesë brenda kishës, por që nga ana tjetër është avangarde ndaj individualizmit dhe akademizmit të thatë në kontekst të idesë për religjionin dhe prezencën e saj në shtigjet e kulturës dhe shkencës botërore. Religjioni i nevojitet njeriut që ai të zbulojë konceptin e qenësisë personale dhe të historisë botërore, që të mund të ndërlidhë konceptin personal me atë të rendit botëror. Unë mendoj, thotë Dostojevski, se nëpërmjet të religjionit , nëpërmjet të gnozis-it (njohjes) do të mundësohet zbulimi i sekretit të personit tim, do të më bëhet e qartë kush jam unë, prej nga kam ardhur; shpresoj se do të arrij ta kuptoj misterin e botës, me të cilën unë jam i lidhur në një mënyrë të drejtëpërdrejtë por të pakuptueshme për mua. Nëse nuk e kuptoj dot rendin dhe sistemin ekzistencial të botës, atëherë

² Hafizović, Reshid, *Teoloski Traktati o Načelima Islamske Vjere*, Sarajevo 1996, f.9.

³ Al-i Imran, 3:19.

⁴ Dostojevski, F.M., *Ruska Religijska Filozofija i F.M. Dostojevski*, përgatiti: N. Berdjajev, Beograd 1982, f. 7.

prezenca ime në histori do të jetë jointerese, e dëshpruar dhe nuk do ta di se për cfarë arsye jetoj.⁵

Vlerësimi për religjionin dhe religjiozitetin, do të thotë subjektin e të cilit i komunikohet shpallja, i bërë nga ana e Dostojevskit është një klithmë që dikund me zë e dikund pa zë dëgjohe në të gjitha traditat fetare. Që nga humanizmi dhe renesansa fetarët jetojnë brenda një shkëputje vulkanore ndërmjet kulturës dhe traditës amë shpirtërore dhe religjioze dhe kulturës moderne, si një paradigmë *sui generis* e botës bashkëkohore. Kjo disharmoni është ndjekur me kriza të shumta të identitetit që cdo person dhe grup fetar e ka përjetuar në trajta të ndryshme.⁶

A kemi analizë diskursive të religjionit...

Diskursi paraqet trajtën se si një dije ose dukuri është e analizuar në shoqërinë konkrete historike dhe në institucionet shoqërore. Praktika diskursive, thotë Fuko (Michel Foucault) karakterizohet me ndarjen e fushës së objektit, përkufizimin e një perpspektive kanonike në kontekst të lëndës njohëse, përcaktimin e trajtës së analizës së konceptit dhe teorisë. Praktika diskursive nuk është trajtë e thjeshtë e prodhimit të diskursit. Ajo formësohet në tubimet teknike, në institucionet, në skemat e sjelljes, në tipet e përcjelljes, në format pedagogjike, të cilët së bashku me trajtësimin edhe imponohen dhe kultivohen.⁷ Vendosja e ndërlidhjes diskursive të teologjisë ose filozofisë së religjionit dhe si rrjedhë e tërë kësaj ortopraktikës fetare do të paraqesë kontekstualizimin dhe identifikimin real të fesë në shoqërinë aktuale njerëzore. Ndërsa nga ana tjetër do të dekontekstualizohet çdo element multiplikativ i identifikimit real të religjionit. Vetëm në këtë mënyrë religjioni ka mundësi të përfasqësorë ndjenjën dhe emocionimin fetar si dhe vendzënien e kësaj ndjenje në kornizat e kulturës botërore.

⁵ Dostojevski ka qenë prej ndjekësve, sic thotë edhe vetë, i gnostikëve lindor të kishës ortodokse sic janë Origeni, Klimenti i Aleksandrisë etj., të cilët kanë qenë ngushtë të lidhur me filozofinë pereniale dhe përvojën religjioze të pastër. Tek ta si edhe te Dostojevski, relacioni sublim fetar mes krijesës dhe Krijuesit ka qenë i eksponuar realisht dhe pa institucionalizim e komente të anshme. Shiko: Dostojevski, *po aty*. f. 17.

⁶ Kuptimet e tradicionit dhe modernitetit dhe ndikimet e tyre mbi religjiozitetin shumë bukur janë analizuar nga mendimtari boshnjak, Adnan Silajxhiq, i cili në mes tjerash thotë:

⁷ Fuko, Mishel, *Rijeçi i stvari*, Beograd, 1971, f.141-181; 383-425.

Në të kundërtën qasjet teorike të cilat nisen nga përfaqësimi vetëm i sinxhirëve të interpretimit, të cilat ndërtojnë formalizëm letrar e gjymtojnë diskursin fetar i cili nuk ka mundësi të jetë “ gjuhë” si ajo e letërsisë, jurisprudencës, apologjetikës.... Diskursi religjioz nuk është i organizuar sipas shembullit të gjuhës utilitare linguistike, por në te bëhet fjalë për një relacion të hapur, por sistematik ndërmjet:

- ortopraktikës fetare si hapësinore, kohore edhe shqisore (dukuri)
- dijes analitike, intelektuale e cila e përbën strukturën e zgjedhjes parapraktike, gjegjësisht sistemit konstituiv të dijes fetare dhe
- përmasa ndiesore transcendentale pa të cilën cdo praktikë dhe intelektualizëm religjioz do të ishte jofetar.

Allahu i Lartëmadhëruar në suren *Asr* në trajtë mjaftë të ngritur dhe hyjnore e përfaqëson këtë diskurs të religjionit i cili është bazë e sjelljes së *homo religiositis* sipas shpalljes së fundit. Fuqia Krijuese urdhëron:

Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

*“ Pasha kohën! Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të sigurt. Me përjashtim të atyre që besuan, që bënë vepra të mira, që porositën njëri-tjetritin t’i përmbahen të vërtetës dhe që këshilluan njëri-tjetritin të jenë të durueshëm”.*⁸

Kjo sure e Kur’anit sqaron se njeriu me duart e veta e përgatit lumturinë dhe shkatërrimin e tij. Njeriu nuk shpëton prej përgjegjësisë nëse e fajëson kohën, shekullin, hapësirën. Diskursi kuranor kategorikisht e mohon arsyetimin e atyre që të mirën e kornizojnë në një kohë të caktuar, ndërsa dobësitë personale i përfaqësojnë si anomali të kohës kur jetojnë. Thënë shkurt: Fisnikëria është në njeriun e jo në kohën. Në ajetin e parë të kësaj sureje Allahu Fuqiptotë betohet në kohën si koncept i korjes njerëzore, si shtrydhje e lëngut njerëzor prej esencës krijuese të tij. Obligimi i besimtarit nuk është të jetë ithtarë i kohës, por pronar i saj. Personi që nuk është pronar i kohës, nuk mund ti shijojë begatitë e saj.⁹

Vetëdija islame mbi kohën është në kontekst linear, që është tipike për religjionet e shpallura: koha fillon me krijimin dhe lundron deri në ditën e Gjykimit, mirëpo kjo

⁸ *Asr*, 103:1-3.

⁹ Islamoglu, Mustafa, *Hayat Kitabı Kur’an*, Istanbul pa datë, f. 1299

kohë lineare në një mënyrë shndërrohet në lëvizje ciklike, gjegjësisht në “ rrugëtimin e besimtarëve të përkushtuar prej vendit të fillimit deri te vendi i kthimit”.¹⁰

Për pasojë njeriu që nuk lëshetë i vetëdijshëm për kohën (e tashme dhe të kthimit) është i humbur. Kushtet bazë të shpëtimit janë dy: besimi dhe vepërmirësia e bazuar në të. Vepërmirësia e bazuar në besimin nuk është e koncentruar në një periudhë të caktuar kohore e përfshinë tërë gjininë njerëzore prej fillimit deri te kthimi. Islami i stolitur me besim të këtillë mund të përkufizohet si “ *realitet eternal i vetëm i vlerave të pandryshueshme të njerëzimit*”. Termi “*amilu’s-saliha*” (vepërmirët, vepërmirësia) në Kur’an përdoret në shumë trajta të ndryshme. Në ajetet që flasin për vitet e para të shpalljes më tepër e thekson “ *sjelljen me përgjegjësi*”¹¹, në vitet e mëpasme theksi i vepërmirësisë fetare është vatrëzuar në “*sjellje e nduarnduartë me besimin*”, në periudhën e formimit të shtetit të Medines më tepër përqëndrohet në “ *përmirësimin e vetes dhe të tjerëve*”.¹² Përqëndrimi i fundit i vepërmirësisë në kontekstin kuranor e paraqet thelbin e këtij parimi të shpalljes dhe në te është universalizuar diskursi religjioz Islam për hapërimin e vepërmirësisë me kohën gjatë të gjitha periudhave të jetës njerëzore në faqen e dheut.

Përderisa njerëzit që merren me teorinë e feve nuk arrijnë që atë ta bartin të dukuri të rëndësishme dhe të patjetërsueshme të kohës nëpërmjet të një diskursi efektiv religjioni nuk do të ketë vendin e merituar në shoqërinë njerëzore.

Kalimi në mijëvjeçarin e ri u përjetua me shumë ngjarje mahnitëse. U përjetuan shumë tronditje kuptimore, proceset kulturore dhe shoqërore e ndryshuan botën, u ballafaquam me kultura dhe subkultura të reja, me stile dhe simbolika të llojllojshme . Të gjitha këta ndryshime i sfidojnë antropologët, kulturologët, politikanët, sociologët, komunikologët, etj. Mirëpo shumë rëndë arrijnë që të sfidojnë teologët që ata të shpëtojnë prej interpretimit imitues shterpë dhe të hapërojnë realisht me kohën kur jetojnë.

¹⁰ Allahu i Lartëmadhëruar në suren *Bekare* urdhëron: “*Të cilët, kur i godet ndonjë e pakëndshme thonë: “Ne jemi të All-llahut dhe ne vetëm tek Ai kthehem!”! Të tillët janë që te Zoti i tyre kanë bekime e mëshirë dhe të tillët janë ata të udhëzuarit në rrugën e drejtë*”.*Bekare*, 2:156-157.

¹¹ Duke filluar prej ajetit të dytë të sures *Bekare* që e shpreh devotshmërinë para udhëzimit, Kurani është bazuar në vetëdijen e përgjegjësisë dhe etikës dhe këtë e shpreh nëpërmjet të aksiologjisë dhe justifikimit hyjnor.

¹² Islamoglu, Mustafa, *po aty*.

Këtë hapërim unë nuk e kuptoj si interpretim i religjionit me fusha joreligjioze, përkundrazi si qasje e vërtetë religjioze ndaj fesë e kërkuar nga universaliteti i shpalljes dhe diskursit hyjnor.

Është fakt se shoqëria e sotme rruzullin e orienton në bazë të ritmit të shpenzimit. Zoti kryesisht është një Fuqi, dikund jashtë, i mënjanuar jashtë saj. Ndërsa teologët dhe teorikët e religjionit më tepër merren me dogmën dhe folklorin fetar se sa me urtinë fetare, më tepër me parimetv e moralizimit shoqëror se sa me shpirtërinë.

Qasja reale religjioze ndaj fesë duhet të jetë e përqëndruar në tri segmente bazë, edhe atë:

- 1. Përfaqësimi intelektual dhe kohor i teologjisë (shkencës mbi parimet besimore).**
- 2. Vendënia reale e ortopraktikës (ibadeteve) në shoqërinë bashkëkohore.**
- 3. Emocionimi dhe entuziazmi adhurues në përjetimin e fesë.**

1. Përfaqësimi intelektual dhe kohor i teologjisë

Kohëve të fundit, dita ditës bëhet më e qartë se shekulli i kaluar ishte një shekull shumë i lëvizshëm për gjininë njerëzore. U bënë zhvillime në shumë lëmi por edhe dy luftëra shkatërruese botërore. Gjinia njerëzore u ballafaqua me katastrofa të ndryshme natyrore, me disbalancë të kushteve jetësore, sëmundje të ndryshme ngjitëse, epidemi.. tek të cilat në masë të madhe shkaktar ishte vet njeriu. Luksi i tepërt u ballafaqua me varfërinë e madhe. Të pasurit u pasuruan edhe më, ndërsa të varfërit edhe më u varfëruan. Kjo situatë ndodhi edhe në përmasat e kontinenteve dhe shteteve dhe si pasojë u paraqitën shtresa të panumërta të urrejtjes dhe padurueshmërisë mes shtresave dhe organizmave shoqërore. Njeriu sa më shumë e fuste në kontrol materien aq ma shumë bëhej rob i saj. Pikërisht për këtë siç u tha më lartë feja mori trajtën e një dukurie që dita ditës i shtohet vlera dhe prezenca në shoqëri.

Sot më feja , në të gjitha përmasat ka funksionin e një modeli në perceptimin real të botës dhe në përcaktimin e vendvendosjes së njeriut në hemisferën botërore.

Për rrjedhojë është më se e nevojshme që feja të jetë funksionale. Nga aspekti i Islamit ky funksionalitet e ka kuptimin e përfaqësimit të një botëkuptimi fetar të gatuar me mendësinë reale botërore. Që do të thotë ne si muslimanë edhe njëherë duhet të analizojmë mirë vehten dhe traditën tonë intelektuale nën lupin e kohës në të cilën jemi duke jetuar. Thënë ndryshe e kemi doemos që ta tejkalojmë veten dhe stereotipet e krijuara në historinë e mendimit dhe veprimit të gjeneratave të muslimanëve, të cilat nuk e kanë vulën e universalitetit kohor dhe hapësinor siç e ka Kur'ani.

Kur'ani si shpallje hyjnore në rend të parë e organizon jetësimin e përditshmërisë njerëzore, ndërsa individit ia pasqyron qëllimin përfundimtar të jetës dhe e mëson që jetën ta shohë nga spektri i një tërësie vlerash. Shpallja, e cila në fillim individëve u ofron një filozofi jetësore, me kalimin e kohës shndërrohet në kulturë dhe identitet shoqëror.¹³ Një pjesë e madhe e problemeve¹⁴ fetare paraqiten për shkak të vendosjes jo të drejtë të raportit mes Kur'anit dhe njeriut. Kur'ani ka cilësitë e dhuruara nga Allahu xh.sh., të cilat e shpëtojnë nga fajësia në këtë realcion, që do të thotë se faji i keqkuptimit, keqinterpretimit assesi nuk është ndikuar nga Kur'ani, por nga njeriu. Burimi i Kur'anit është hyjnor¹⁵, është i dërguar për udhëzimin dhe informimin e njerëzve në të vërtetat hyjnore¹⁶, atij e pavërteta nuk mund t'i mvishet nga asnjë anë¹⁷, nuk ka asnjë kundërshtim me natyrshmërinë njerëzore¹⁸, është libër i fundit dhe

¹³ Dërgimi e pejgamberit shpalljes hyjnore ia ka mundësuar kapshmërinë njerëzore, do të thotë, fjala transcendentale e Zotit është mishëruar në Pejgamberin dhe e ka përfituar vlerën funksionale brendahistorike. Këtë përmasë individuale të shpalljes, Pejgamberi a.s. që prej ditëve të para ua ka bartur shokëve-as'habëve të vet dhe si pasojë shpallja është socializuar, që do të thotë se ka marrë trajtën e rregullimit dhe sistematizimit të shoqërisë njerëzore, ndërsa me gjeneratat vijuese të muslimanëve shpallja ka përfituar përmasën e një kulture dhe qytetërimi të caktuar. Pikërisht për këtë prerje me neshter e çdonjëres prej këtyre përmasave, që shpeshherë është e inicuar si kthim drejtë pastërtisë absolute ose puritanizmit fetar e lë të gjymtë botëkuptimin fetar dhe shkakton ndërprerje të vazhdimësisë historike dhe mëkëmbëse të mendimit fetar.

¹⁴ Më i kënaqur do të isha sikur këtu në vend të *problemit* të kisha përdorur termin kur'anor *sëmundje*, pasi çështja drejtpërsëdrejti ka të bëjë me përmasën metafizike të sëmundjes. “Në zemrat e tyre kanë sëmundje, e Allahu u shton sëmundje edhe më shumë, e për shkak se ata përgënjeshtruan, pësojnë dënim të dhembshëm”. El-Bekare, 10.

¹⁵ “Ne e zbritëm atë në natën e Kadrit”. El-Kadr, 1.

¹⁶ “Muaji i Ramazanit që në të shpallet Kur'ani, që është udhërrëfyes për njerëz dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i të vërtetës nga gënjeshtra)” el-Bekare, 185.

¹⁷ “Atij nuk mund t'i mvishet e pavërteta nga asnjë anë; është i zbritur prej të Urtit, të Lavdishmit”. Fussilet, 42.

i mbrojtur nga Allahu xh.sh.¹⁹. Kur'ani është burimi parësor i fesë dhe i sistemeve mendore të lidhura me Islamin.

Siç u tha edhe më sipër, porosia kur'anore është universale dhe qëllimi i saj është udhëzimi dhe informimi i drejtë i të gjithë njerëzve. Mirëpo në këtë veprimtari Kur'ani është pasiv, ndërsa aktiv është njeriu, që d.t.th. se njeriu është krejtësisht i lirë ta pranojë ose mos ta pranojë këtë porosi. Parapëlqimi i cili do të bëhet me dëshirë të lirë e përbën pikën e parë të raportit të njeriut me Kur'anin. Pikërisht për këtë Kur'ani, si dhe bartësi i tij në shoqërinë njerëzore Muhammedi a.s., prej njeriut së pari kërkon që t'i besojë e më vonë të konsultojë dije kur'anore dhe ta sendërtojë atë në përditshmërinë e tij. Në mesin e ajeteve të para të zbritura hasim në tre ajete të cilat kanë të bëjnë me esencën e dërgesës hyjnore, *Kur'anit dhe Pejgamberit*. Ato janë: a) Përmasa e universalitetit të tyre, me qëllim që tërë njerëzimit t'ia përkujtojë praninë e Zotit; b) natyra e përbotshme e tyre dhe funksioni i udhërrëfyesit; dhe c) roli i shembullit dhe fjalës së bukur i prezentuar në to.²⁰

Muhammed Ikbali, në ndërtimin e mendimit të tij kritik ndaj gjendjes aktuale të mendësisë muslimane të kohës së vet, për referencë themelore ka marrë tërësinë kur'anore dhe me një varg konferencash shkencore dhe veprash të shkruara ka tërhequr vëmendjen për jetësimin urgjent të rrjedhave zhvillimore të mendësisë dhe intelektualitetit njerëzor edhe në hapësirën muslimane. Ai para së gjithash ka qenë për rianalizimin e mendimit fetar. Me ***“Ripërtëritjen e mendimit fetar”***, siç thotë edhe vetë, ai ka për qëllim që ***duke i qëndruar besnik traditës filozofike islame dhe duke u***

¹⁸ “A nuk e përfillin ata Kur'anin? Sikur të ishte prej dikujt tjetër, përveç prej Allahut, do të gjenin në të shumë kundërthënie”. En-Nisa, 82.

¹⁹ “Ne me madhërinë Tonë e shpallëm Kur'anin dhe Ne gjithsesi jemi mbrojtës të tij”. El-Hixhr, 9.

²⁰ “Ne nuk të dërguam ty ndryshe vetëm se për të gjithë njerëzit myzhdedhënës dhe tërheqës i vërejtjes, por shumica e njerëzve nuk e dinë”. Es-Sebee, 28; “Ai që ia shpalli Furkanin (Kur'anin dallues të së vërtetës nga e pavërteta) robit të vet që të bëhet pejgamber i botës është i madhëruar”. El-Furkan, 1. “Thuaj: Nëse e doni Allahun, atëherë ejani pas meje që Allahu t'ju dojë, t'ju falë mëkatet tuaja, se Allahu është që fal shumë, mëshiron shumë”. Ali Imran, 31. “Thuaj: Unë jam vetëm njeri sikur edhe ju, mua më shpallet se vetëm një Zot është Zoti juaj, e kush është që e shpreson takimin e Zotit të vet, le të bëjë vepër të mirë, e në adhurimin ndaj Zotit të tij të mos e përziejë askë”. El-Kehf, 110. “Ju e kishit shembullin më të lartë në të dërguarin e Allahut, kuptohet, ai që shpreson në shpërblimin e Allahut në botën tjetër, ai që atë shpresë e shoqëron duke e përmendur shumë shpesh Allahun”. El-Ahzab, 21. “A nuk ke kuptuar se si Allahu bëri shembull: fjalën e mirë si pema e mirë që rrënjët e saj janë thellë e degët e saj janë lart në qiell”. Ibrahim, 24.

bazuar në zhvillimet shkencore në fusha, të ndryshme të rindërtojë filozofinë dhe mendësinë islame.²¹ Ndryshimet dhe zhvillimet e paraqitura në fushën shkencore

ndikuan që mendimi në botëvështrimin e Ikbali të ketë karakter dinamik e jo statik.

Ikbali pohon se ka ardhur dhe ka kaluar koha e analizës dhe vlerësimit objektiv të themeleve të fesë islame. Edhe pse në disa raste do të kundërshtohemi me të parët tanë, thotë Muhammed Ikbali, kjo çështje është domosdoshmëri²². E kaluara duhet të konsiderohet çështje e dijes e assesi çështje e doktrinës.²³

Muhammed Ikbali ripërtëritjen intelektuale dhe fetare të muslimanëve e analizon në dy etapa.

Etapa e parë, e quajtur etapa e diagnostikimit, është shkalla e analizës së shkaqeve dhe faktorëve historikë dhe bashkëkohorë, të cilët i kanë shtyrë muslimanët në këtë gjendje që janë. Ndërsa etapa e dytë, etapa e shërimit, përmban ndryshimet dhe ripërtëritjen e muslimanëve nga aspekti doktrinar, politik dhe shoqëror. Do të thotë se ripërtëritja e mendimit islamik tek Ikbali me vete tërheq edhe ndryshimin dhe ripërtëritjen shoqërore të muslimanëve. Ajo që më së tepërmi e shtyu Ikbali në mendojë për ripërtëritjen është gjendja e mjeruar lëndore dhe kuptimore e muslimanëve në botë. Qëllimi kryesor i fesë, thotë Ikbali, qëndron në përmirësimin e individualitetit njerëzor dhe të shoqërisë ku ai jeton.²⁴ Për pasojë, përpjekja e Ikbali nuk është vetëm për gjetjen e Zotit, por njëkohësisht edhe për rehatinë e jetës së njeriut në këtë botë. I tërë korpusi mendor i Ikbali është i përqendruar në përforcimin e vetëbesimit dhe unit, si të muslimanët ashtu edhe të të gjithë njerëzit.

Pikërisht për këtë nevojitet ndërtimi dhe strukturuimi i çështjeve teologjike në bazë të prioriteteve kohore. Këta modele të veprimtarisë intelektuale teologjike janë në përmbajtje ajeteve kuranore. Teologjia islame doemos duhet të thellohet pak më tepër në ontologjinë e njeriut, gjegjësisht duhet të krijojë një antropologji kuranore të

²¹ “Në këto ligjërata, thotë Ikbali, të organizuara me kërkesë të Shoqatës Muslimane në Madras dhe që janë mbajtur në Madras, Hajdarabad dhe Aligarh, jam orvatur t’i përgjigjem, ndonëse pjesërisht kësaj kërkesë të pavonueshme, duke u përpjekur të përtërij filozofinë fetare islame, duke pasur denjësisht në konsideratë traditat filozofike të Islamit dhe përparimit më të ri në fushat e ndryshme të njohjes njerëzore”. Ikbali, Muhammed, *Ripërtëritja e mendimit fetar në islam*, përkth. Nexhat S. Ibrahim, Shkup 2006, f. 10.

²² *Po aty*, f. 89-95.

²³ *Po aty*, f.163-168.

²⁴ *Po aty*, f. 127.

modeluar me gjuhën e bashkëkohësisë. Teologjia klasike në masë të madhe e ka mbajtur në plan të dytë vullnetin dhe cilësinë krijuese/prodhuese të njeriut dhe atë në të shumtën e rasteve e ka diskutuar si një “robot” që deshti ose jo duhet të veprojë në bazë të urdhëresave apo ndalesave, të cilat në të shumtën e rasteve edhe nuk u sqaruan sa duhet. Për pasojë duhet të kemi një teologji e cila don të largohet prej diskursit shterpë të mesjetës dhe do të diskutojë njeriun duke patur parasysh ndërtimin psikologjik dhe rrethanat shoqërore të tij. Si e tillë teoria teologjike do të përfaqësojë filozofinë e jetës dhe do ti shërbejë njeriut në kuptimin e essences personale, në sistemimin e jetës së tij, në kuptimin e mjedisit actual jetësor, në krijimin e prapavijës shpirtërore/kuptimore në ballafaqimin me problemet e ndryshme të jetës...

Gjithashtu teologjia islame duhet të ripërtrijë teorinë e saj në lidhje me natyrën. Që nga shekulli i XVII shkenca ka përjetuar zhvillime marramendëse në kozmologji. Më është e pafalshme që kozmologjia të përdoret vetëm në ndërtimin e provave për argumentimin e Zotit ose për mposhtjen e provave ateiste në këtë fushë. Është e domosdoshme që të vatërzohet dhe të bëhet koshient se ai vetë është pjesë e gjithësisë dhe çdo prishje dhe disekuilibër kozmik do të thotë edhe shkatërrim i tij. Problemet bashkëkohore kozmologjike duhet të jenë pjesë e diskursit real të teologjisë islame.

Tjetërsimi, tëhuajësimi dhe inferioriteti në korniza globale e muslimanëve duhet të diskutohet në përmasat e besimit dhe teorisë së besimit. Për shkak se shoqëritë muslimane kanë mbetur pa rrugëdalje në këtë arenë të zhvillimit marramendës të teknologjisë. Për pasojë ata e kanë humbur krijeshmërinë dhe prodhueshmërinë dhe janë strukur në imitimin e verbër të të tjerëve . Disa here ky imitim i ka ngritur , por shpeshherë kanë shërbyer si pilot programe të shteteve dhe shoqëriive të zhvilluara.

Teologjia islame gjithashtu duhet të diskutojë krizat etike, lëkundjet shoqërore dhe keqpërdorimet religjioze. Sa më shumë njeriu që duket i zhvilluar materialisht, aq më shumë e ndjen krizën e shpirtërisë së tij. Besimi dhe teoria e besimit atij duhet t’i mundësojë një siguri ekzistenciale dhe cilësore.

Çështjet sfiduese të etikës dhe bioetikës janë problemet bazë të teologjisë moderne. Pyetjet bioetike që e problematizojnë fillimin e jetës së njeriut, çështjet e abortusit, inzhinjeringut gjenetik, ushqimit të modifikuar gjenetik, klonimi, eutanazija,

transplantimi I organeve, mbrojtja e mjedisit janë sfida të shkencës bashkëkohore por edhe të religjionit dhe teorisë teologjike.²⁵

Teologjia islame bashkëkohore doemos duhet të merret me këto çështje nëse ka dëshirë të hapërojë me zhvillimet reale të njerëzimit, në të kundërtën do të jetë e izoluar në korniza të grupimeve të vogla të prira nga vetëdija getoiste.

2. **Vendzënia reale e ortopraktikës (ibadeteve) në shoqërinë bashkëkohore.**

Kur'ani përkushtimin e vërtetë ndaj Krijuesit(ibadet) dhe dorëzimin e lirisë në duart e të Lartmadhëruarit (abd) e ka stilizuar prej rrënjës së njëjtë të gjuhës arabe **a-b-d**.²⁶ Fjala “ibadet” në aspekt gjuhësor d.t.th. *përkushtim, modesti, respekt, adhurim, skllëvëri* Ndërsa në përmasën fetare islame ka kuptim të *sjelljes përkushtimore të besimtarit për të arritur kënaqësinë e Allahut xh.sh. , shkalla më e lartë e modestisë dhe respektit ndaj Allahut xh.sh., të veprave dhe adhurimeve nëpërmjet të cilave arrihet afërsia maksimale ndërmjet njeriut dhe Allahut.*²⁷

Në çdo periudhë të jetës së njeriut në faqen e dheut ai ka ndjejtur nevojën për përfaqësimin e besimit të tij ndaj Fuqisë Krijuese , që e ka emërtuar dhe parafytyruar në trajta të ndryshme. Një realitet të tillë e provon edhe antropologjia kulturore jo vetëm në fetë e shpallura por edhe në ata më primitivet. Studjimet psikologjike vërtetojnë se ndjenja fetare dhe ndjenjat e përkushtimit, respektit dhe dashurisë ndaj Absolutit janë të lindura. Si rrjedhojë ortopraktika fetare nuk është vetëm kërkesë

²⁵ Më gjerë në lidhje me këto çështje shih: Hafizović, Reshid, *Savremene Akadske Teme II*, Sarajevo 2006.

²⁶ Allahu xh.sh. në Kur'an edhe për rrugëtimin e Pejgamberit a.s. prej Mekës deri në Jerusalem për një pjesë të natës (Isra) e përdor epitelin “ abd” për Muhammedin a.s.. Si duket rastin më metaracional dhe më përjetues nga aspekti i besimit për ndjekësit e Pejgamberit a.s., Isra'në dhe Miraxh'in, Allahu i Lartmadhëruar ia materializon vetë Pejgamberit në pozicionimin e robit. Shpeshherë kur përmendet Pejgamberi a.s. logjika e drejtë kërkon që të pranojmë se epiteli më i lartë i tij ishte profetësia, që është çështje e zgjedhjes hyjnore. Mirëpo Allahu xh. sh. epitelin e përkushtimit të Pejgamberit e sheh si më të lartë nga aspekti i lidhjes mes njeriut dhe Zotit. Në ajet thuhet: “*Pa të meta është Lartmadhëria e Atij që robin e Vet e kaloi në një pjesë të natës prej Mesxhidi Haramit (prej Qabes) gjer në Mesxhidi Aksa (Bejti Mukaddes), rrethinën e të cilës Ne e kemi bekuar, (ia bëmë këtë udhëtim) për t'ia treguar atij disa nga argumentet Tona.Vërtet, Ai është dëgjuesi (i fjalëve të Muhammedit), pamësi (i punëve të Muhammedit)*”. Shiko: Isra, 17:1.

²⁷ Në lidhje me përkufizimin e ibadetit shiko: Xhurxhani, Sejjid Sherif, *Kitabu't-Tarifati*, Bejrut 1403/1983, f.146.

hyjnore por edhe element struktural i genies njerëzore. Karakterologjia humane nuk kënaqet me atë që lidhja mes njeriut dhe Zotit të jertë e përqëndruar vetëm në disa koncepte abstrakte por edhe në lëvizje dhe praktikë konkrete. Nëpërmjet të ibadeteve feja kalon prej përmasës abstrakte në atë konkrete. Ndryshe nga fetë tjera, Islami ibadetet nuk i ka përkufizuar vetëm me lëvizje simbolike por ata i ka bartur në të gjitha sferat e jetës, gjegjësisht e ka ibadetizuar jetën e njeriut.²⁸ Si pasojë e një botëkuptimi jetësor të tillë, siç thotë edhe Muhammed Ikbali, njeriu e vendos në zemër Fuqinë Krijuese dhe i shtohet vetëdija për realitetin e gjërave përreth vetes. Krahas shtërngimeve dhe relaksimeve etike që i ka në vehte ai është më i thiruri prej krijesave që të inkuadrohet në vazhdimësinë krijuese të Krijuesit.²⁹

Njeriu, sipas Ikbali, ka vetëdije për unin dhe kjo vetëdije e tij ka disa gjendje përmbajtjesore që janë në lidhje të ngushtë mes vetes. Nga aspekti i unëve të ndarë, çdo njeri është krijesë që mendon, beson, ndien dhimbje, ka qëllime dhe vlerëson alternativat. Thënë ndryshe janë krijesa që kanë gjendje të caktuara shpirtërore dhe intelektuale. Përvoja e unit është një përvojë e cila pandërprerë është në zhvillim, në vazhdimësi ndryshon dhe kalon prej një përmase në tjetrën. Uni ose egoja paraqitet si bashkësi e gjendjeve intelektuale ose përmbajtjeve shpirtërore tona. Këto përmbajtje nuk ekzistojnë dot të ndara njëra prej tjetrës. Secila prej tyre ndikon në tjetrën ose e sqaron atë. Tërësia e intelektit dallohet nga tërësia fizike. Përderisa trupi i njeriut është i varur prej hapësirës, intelektin nuk është i tillë. Cilësia parësore e unit njerëzor është tërësia dhe uniteti i përmbajtjeve të tij.

Intelekti njerëzor gjithashtu edhe dallohet me unitetin e përfundimit për çështje të caktuara. Për të arritur deri te një përfundim i caktuar intelektin duhet njëlloj të besojë në të gjitha premisat e analogjisë logjike. D.t.th. përderisa të dy premisat nuk dalin nga i njëjti intelekt përfundimi nuk është i drejtë. Për pasojë gëzimi, shijet, brengat dhe ndjesitë janë të njëjti intelekt ose vetëdijeje, e assesi e dikujt tjetër dhe si të tilla janë kahe të ndryshme të të njëjtut unë. Pikërisht për këtë askush nuk mund të vendosë për askënd. Asnjë unë nuk mund ta përjetojë përvojën e unit tjetër. Ikbali në përcaktimin e esencës së unit është bazuar në mendimet e William Jamesit. W. Jamesi

²⁸ Në një ajet të Kur'anit urdhërohet: “*Thuaj: “Namazi im, kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime janë thjesht për All-llahun, Zotin e botëve”*”. En’am, 6:162

²⁹ Ikbali, Muhammed, *Ripërtrirja e mendimit fetar në islam*, Shkup 2006, f.115-120.

gjendjen vetëdijesore e cilëson si “lumë i mendimit”. Në rrjedhën e këtij lumi ka hallka të ndryshme të cilat i bashkëngjiten rrjedhës së aktivitetit të intelektit dhe formojnë një zinxhir. Në këtë pikë uni bëhet ndjenjë e individualitetit dhe e paraqet një pjesë të sistemit tonë mendor. Lëvizja e vazhdueshme dhe aktiviteti i unit e përbën përvojën e brendshme, ndërsa ajo inkadrimin e unit në proceset jetësore. Kur njeriu percepton diçka, kur e shpreh mendimin në lidhje me diçka ose kur e përdor dëshirën e tij, ai është ballë për ballë me unin e tij. Uni për Ikbali është energji orientuese e trajtësuar dhe sistematizuar nga përvoja e brendshme.³⁰ Kur’ani në lidhje me detyrën nxitëse dhe drejtuese të unit, thotë Ikbali, i përdor këto fjalë: *Të pyesin ty për shpirtin. Thuaj: Shpirti është çështje që i përket vetëm Zotit tim, e juve ju është dhënë fort pak dije.*³¹

Ikbali në komentimin e këtij ajeti i përdor termet “halk” (krijim) dhe “emr” (urdhër, drejtim). “Halk”, thotë Ikbali, d.t.th. krijim, ngjarje; ndërsa “emr”, drejtim, orientim. Kur’ani edhe për krijimin edhe për drejtimin thotë se janë të Zotit.³²

Duke u mbështetur në ajetin 85 të sures Isra, Ikbali thotë se esenca e vërtetë e shpirtit është cilësia e nxitjes dhe e dirigjimit. Kjo cilësi e bën të domosdoshëm shpirtin që të jetë krijesë e thjeshtë (jo e përbërë) dhe me unitet të vetin.³³ Ndërsa në komentimin e ajetit, Isra 84³⁴ fjalën **ja’melu** (vepron, sillet), e kupton si cilësi esenciale të krijimit tonë dhe thotë se personi i vërtetë i jonë nuk është “gjë” por është “veprim” (akt). Është ky një veprim i vazhdueshëm, në lëvizje, ndikon dhe ndikohet, dëshiron dhe ka një qëllim të caktuar. Përvoja e unit është sistemi i veprimeve të cilat janë të lidhura mes vetes dhe të cilat mbahen në unitet nga një qëllim drejtues i tyre. I tërë realiteti i tij është i fshehur në sjelljen drejtuese, orientuese të tij. Për rrjedhojë unin tim duhet ta kuptoni dhe ta vlerësoni sipas vendimeve që i marr, sjelljeve të vetëdijshme dhe në bazë të qëllimeve dhe synimeve të mia.³⁵

³⁰ Ikbali, *po aty*, f.135-6.

³¹ Isra, 17:85.

³² “Vërtet Zoti juaj, Allahu është Ai që krijoi qiejt e tokën brenda gjashtë ditësh, pastaj qëndroi mbi Arsh, Ai e mbulon ditën me natën, që me të shpejtë e kërkon atë, edhe dielli, edhe hëna e edhe yjet, i janë të nënshtruar urdhrit të Tij. Ja, vetëm Atij i takon krijimi dhe urdhri. I madhëruar është Allahu. Zoti i botëve”. A’raf, 7:54.

³³ Ikbali, *po aty*, f.136

³⁴ “Thuaj: Çdokush vepron sipas hamendjes së vet, dhe vetëm Krijuesi juaj e di kush është në rrugë të drejtë”. Isra 17:84.

³⁵ Ikbali, *po aty*, f. 137.

Besimtari në mendimin dinamik të Ikballet është tejet serioz edhe në punët e kësaj bote. Ai, përtacinë e cila e tërheq shoqërinë drejt shkatërrimit dhe lënien mënjane të çështjeve të kësaj bote duke e treguar si shkak devotshmërinë, i satirizon në poezinë e quajtur “*Namazi i Robërve*”.³⁶

“Besimtari turk pas namazit më pyeti:

Pse imami i juaj është kaq i ngadalshëm në ibadetin?

Mbrojtësi i besimit që ishte i lirë, s’e kuptoi dot namazin e robërve.

Njerëzit e lirë kanë të bëjnë edhe shumë punë

Por ç’të bënte robi i gjorë larg ibadetit?”

Është më se e qartë se në sistemin mendor të Ikballet ka një dinamikë të pashoq. Ai krahas mendimit, rëndësi të veçantë i kushton edhe veprimit, pasi është i mendimit se Kur’ani i kushton më tepër kujdes veprimit se sa teorisë. Konstelacioni i tillë i mendimit të Ikballet është i ndikuar prej disa shkaqeve historike dhe sociologjike. Veprimi ishte mënyra e vetme se si Ikballet do të kishte mundësi ta zgjonte dhe freskonte popullatën e hapësirës ku ai jetonte. Para se të fliste për gjërat tjera, Ikballet kishte nevojë që njeriut të nënqiellit të vet, i cili e kishte humbur unën t’i mundësonte ta përfitojë përsëri atë. Ai pothuajse në tërë opusin e shkrimeve të veta me një metodë mjaftë ndikuese flet për përforcimin e unit dhe kthimin e vetëbesimit tek muslimanët. Ja pra në këtë mënyrë Muhammed Ikballet nëpërmjet të dinamizimit të un’it njerëzor në veprimtarinë horizontale botërore e fut ortopraktikën fetare si element bazë të zgjimit dhe zhvillimit ose ndryshimit njerëzor. Ai, si edhe shumë filozofë të besimeve të tjera, është i vetëdijshëm se vetëm shpirti, gjegjësisht un’i i qetë ka mundësi të gjenerojë energji pozitive.

Adhurimi (Ibadeti) në jetën e njeriut nuk paraqet çështje të rastësishme dhe kalimtare, por është çështje bazike dhe e kuptimtë ejetës së njeriut. Më saktë Kur’ani në shumë vende flet për adhurimin e tërë ekzistencës në trajta të ndryshme dhe me një fjalë e përfasqëson ibadetin si qëllim kryesor dhe çekrek elementar të jetës së

³⁶ Muhammed Ikballet këtë poezi e ka shkruar si përgjigje për kryetarin e komisionit të Gjysmëhënës së Kuqe të Republikës së Turqisë, e cila në vitin 1935 e kishte vizituar Lahoren dhe së bashku me Ikballet kishin shkruar të falin namazin në një xhami të qytetit. Imami i xhamisë e kishte zgjatur tepër faljen, ndërsa pas përfundimit të namazit kryetari i delegacionit turk e kishte pyetur Ikballet për shkakun e zgjatjes së namazit e Ikballet është përgjigjur me këtë poezi. Shiko: Ikballet, Muhammed, *Armagan-i Hicaz*, f. 207.

njeriut në këtë botë. Nëpërmjet të nënshtrimit, përkuljes, lutjes dhe ibadetit tërësia qenësore e tregon përkushtimin e vet ndaj Fuqisë Krijuese.³⁷ Njeriu për dallim nga të gjitha qeniet tjera e adhuron Allahun xh.sh. me vetëdije dhe dëshirë të lirë dhe nëpërmjet të kësaj arrinë të ngritet në përmasën e shfrytëzuesit të begative hyjnore të krijuara nga Zoti dhe të lartësohet në platformën e krijesës më të përsosur. Shpesh ka ndodhur që njeriu gjatë periudhave të ndryshme të largohet prej kësaj ortopraktike fetare dhe të devijojë. Me devijimin prej qëllimit të qenësisë, në dimension ideor, praktik dhe etik, ballafaqohet me degradim të njerëzshmërisë dhe karakterit esencial të vetë qenies njerëzore. Me një situatë të ngjashme jemi të ballafaquar në periudhën bashkëkohore, ku njeriu i tëhuajësuar dhe tjetrtësuar prej adhurimit të vërtetë të Zotit orientohet në adhurime të tjera të cilat nuk kanë esencë të shpalljes dhe hyjnisë.

Njeriu nëpërmjet të ibadetit e pranon pushtetin ontologjik të Zotit mbi individualitetin e tij dhe hyn në një nduarnduarsi etike me Të. Ai e përjeton pozitën e vërtetë të tij në ekzistencë, fuqinë dhe kufijtë e fuqisë së tij.

Adhurimi gjithashtu është një obligim intelektual dhe ndërgjegjësor. Individët që kanë ndërgjegje të pastër dhe arsye të shëndoshë e kuptojnë qartë vërtetësinë e përkuljes ndaj Allahut xh.sh dhe nuk ka problem me nënshtrimin. Ibadetet në fenë islame janë relacion me të shenjtën dhe shprehje e fetarësisë së pastër dhe si pasojë në personin e njeriut e krijon një hapësirë psikologjike përplotë me entuziazëm kuptimor, qetësi shpirtërore dhe motivacion absolut për jetë. Adhurimi e bën të kuptimtë jetën, vdekjen dhe përmasat tejfizike, gjegjësisht jetën pas vdekjes. A ka mundësi më të mirë për njerëzshmërinë e kësaj krijese të krijuar në trajtën më të bukur?

3. Emocionimi dhe entuziazmi adhurues në përjetimin e fesë

³⁷ Ra'd, 13:15; Nahl, 16:48; Isra, 17:44; Rahman, 55:5-6;

Zhvillimi marramendës i teknologjisë dhe zbulimi i përditshëm i çështjeve të reja materiale nga njëra anë ia lehtëson jetën njeriut brenda kufijve botërore, mirëpo nga ana tjetër ia harron dhe ia neglizhon veten e tij. Njeriu përballë makinave të llojloshme dita ditës zvogëlohet dhe e humb peshën e tij. Për pasojë e tërë filozofia jetësore e njeriut është e koncentruar në përkapjen dhe mësimin e drejtë të drejtimit të makinerisë fizike për kontrollimin e botës. Vlerat, pa të cilat dikur as që mund të mendohej jeta dhe të cilat e stolisin shpirtin dhe etikën e njeriut, siç janë: *feja, poezia, etika, muzika*, u hodhën në plan të dytë dhe të pakta janë zërat të cilët pëshpërisin për to. Një praktikë e tillë shoqërinë njerëzore e shndërroi në vend të padurueshëm për jetë, ia humbi karakterin humanitetit dhe dashurisë ndërnjerëzore.

Në këtë situatë njeriut i nevojitet të mësojë deshifrimin e topografisë së brendshme të tij dhe duke fituar forcën prej brendie ta rikthejë vetëbesimin dhe të bëhet zotërues i unit të vet.

Hazreti Mevlana³⁸ njeriut ia tregon rrugën drejtë origjinës së tij dhe nëpërmjet të saj e afron në dashurinë ndaj Zotit. Nëpërmjet dashurisë së vërtetë i mundëson të shohë tërësinë dhe të mos humbet në pjesën. Ai si një mjeshtër i mirë e jep planin e bashkimit të pjesëve të ndara, dhe i pajton “un”-ët e ndara. Ai në veprën e tij në mënyrë fascinate i paraqet pikat e përbashkëta të njerëzve dhe nëpërmjet të stërvitjes kuptimore u mundëson të mos mendojnë për dallimet dhe mëngësitë e tjetrit. Një botëvështrim i tillë përgatit fushën e mirëkuptimit të ndërsjellë në shoqërinë e gjithëmbarshme njerëzore.

Nëse shëtitemi në faqet e veprave të shkruara nga ana e Mevlanës do të shohim se secila prej tyre paraqet një disiplinë ose art në vete, ndërsa ajo që i bashkon të gjitha

³⁸ Mevlana Xhelaeddin Rumi lindi në Belh në vitin 1207. Ai është prej dijetarëve më me emër të mijëvjeçarit të dytë. Qysh si fëmijë së bashku me familjen nën udhëheqjen e babait të tij Bahauddin Veledit (v. 1231) u shpërngulën prej Belhi dhe pas një udhëtimit të gjatë u vendosën në Konjë, Anadoli. Një kohë të gjatë Mevlana ligjëroi në medresetë më të famshme të Konjës dhe deri në takimin me Shems-i Tebriziun në vitin 1244 vazhdoi të kryejë detyrën e tij të mësimdhënësit. Pas takimit me Shemsin jeta e tij ndryshoi në tërësi, ai u largua prej medresetës dhe u zhyt në disiplinën ezoterike. Vdiq në vitin 1273. Vepra më e njohur e tij pa dyshim është *Mesnevi*, ndërsa shkroi edhe vepra të tjera si: *Divan-i Kebir*, *Mexhalis-i seb'a*, *Fihi ma Fih*, etj.. Më gjerë shiko: Eflaki, Ahmed, *Menakibu'l-Arifin*, përkth. Në turq. Tahsin Jayixhi, f.1/8,16, 17, 40; *Sipehsalar*, f. 19; Sultan Veled, *Istidatname*, f. 195-96.

është sfondi i shëndoshë filozofik-teologjik dhe sistematik. Vet ai në *Mesnevi* thotë kështu:

“Sekreti im, nuk është larg prej rënkimit tim

Mirëpo nevojitet dritë në sy që ta sheh, aftësi në vesh që ta dëgjojë”.

D.t.th. se ai në veprimtarinë e tij ka të fshehur një sfond mendor dhe artistik që në vargjet e mësipërme është e shprehur me simbolet e syrit dhe të veshit. Mirëpo kuptimi dhe pranimi i këtij sekreti, mesazhi ose ndjenje është i kushtëzuar me aftësinë e shikimit dhe dëgjimit të shëndoshë.

Në brendinë e shprehjeve të Mevlanës ka një kuadro mjaft të pasur të mendimtarëve të cilët janë të prezentuar në role të ndryshme por në hijen e sistemeve të tyre filozofike. Ai Pitagorën, Platonin, Galenin, Feriduddin Attarin, Raziun dhe fytyra tjera të perëndimit e të lindjes i përmend si personalitete mjaft të njohura për të. Ndërsa numri i filozofëve, poetëve dhe dijetarëve që ua ka prezentuar vetëm mendimet është shumë i madh. Thënë shkurt ai veten e prezenton brenda brumit teleologjik artistik-filozofik të kohës kur ka jetuar dhe më parë. Ai thotë kështu:

“Mu si kompas, ne njërën këmbë e kemi të ngulur në fe

ndërsa këmba tjetër i shetit shtatëdhjetë e dy besime e mendime”.

Krahas kësaj nuk duhet të harrohet se Mevlana padyshim në veprat e tij frymëzimin më të thellë e ka marrë prej shpalljes. Djali i tij Sulltan Veledi për Mevlanën dhe mistikët e ngjashëm me të thotë: *“Poezia e miqve të Zotit nuk është asgjë tjetër përveç se sqarim i sekreteve të shpalljes. Ata e shkrijnë unin e tyre dhe ekzistojnë me Zotin”.* Shpallja në poezinë dhe veprën e Mevlanës gjithmonë e ruan dydimensionalitetin e saj. Ai asnjë shtresë të qenësisë nuk e nxjerr jashtë kapshmërisë së revelatës. Në veprën e tij *Fih Ma Fih* në lidhje me shpalljen ai thotë: *“Kur’ani ka dy anë. Disa e diskutojnë njërën kurse disa të tjerë tjetrën. Që të dyja janë të vërteta dhe të drejta, meqë Zoti i Lartë ka dëshirë që të dyja palët të shfrytëzojnë atë. Për shembull, nëse një grua ka burrin dhe një foshnjë në gji, gruaja prej të dyve ndjen kënaqësi por në forma të ndryshme. Kënaqësia e foshnjës është në qumshtin e nënës, ndërsa kënaqësia e burrit në bashkëshortësinë. Njerëzit janë ithtarë të një rruge. Secili ka mundësi të kënaqet me dukshmërinë e Kur’anit dhe të pijë qumësht prej tij.*

Vetëm për të pjekurit në kuptimet e Kur'anit ka një kënaqësi të posaçme dhe atë e kuptojnë vetëm ata”.

Simbolet e prezentuara në veprën e Mevlanës i përfaqësojnë pothuajse të gjitha traditat intelektuale dhe religjioze të kohës së tij dhe më parë. Si pasojë Mevlana në veprën e tij tregon në mënyrë mjaft artistike se të menduarit nuk është tubim i diturive prej vendeve të ndryshme dhe prezentim i tyre në letër, me vërejtje se bleta nuk ka mundësi të bëjë mjaltën pa i shëtitur disa kopshte me lule të ndryshme. Njëllon siç bleta nektarin e tubuar prej luleve të ndryshme e transformon në mjaltë, ashtu edhe mendimtari atë e bën me mendimet, thotë Mevlana.

Kopshtet me lule të shëtitura nga ana e Mevlanës janë shumë, por edhe lulet brenda tyre janë të shumëllojshme. Mevlana si bleta e tubon nektarin prej luleve të ndryshme dhe njerëzimin i paraqet mjaltën shëruese dhe të këndshme të humanizmit teocentrik. Njeriu i cili do ta gjejë veten dhe duke gërryer në thellësitë e ndërgjegjes dhe vetëdijes së shëndoshë do të edukojë si duhet unin e tij do të përfitojë një platformë të artë të lumturisë. Do të përfitojë platformën e ëmbël të shijes së besimit dhe nënshtrimit më të Madhit. Do të kuptojë prej fillimit njeriun, gjërat dhe do të njohtohet me komentin metakozmik të tyre. Thënë shkurt do të qëndrojë karshi Realitetit të urtë të ekzistencës.

Këtë ese te shkurter kam dëshirë ta përfundoj me disa fjale te amshueshme te Mevlana Xhelaluddin Rumiut qe asnjehere nuk e kane humbur aktualitetin e vet:

Bëhu si lumi në bujari dhe ndihmë,

Bëhu si dielli në zemërgjerësi dhe mëshirë

Bëhu si nata në mbulimin e mëngësive të tjetrit,

Bëhu si i vdekuri në hidhërim dhe kërcënim,

Bëhu si dheu në modesti,

Bëhu si deti në mirëkuptim,

Si do që të bëhesh,

Ose duku ashtu si je

Ose bëhu ashtu si dukesh.

R E Z I M E

Situata religjioze në botën e sodit karakterizohet me dy pika ekstremisht të kundërta me njëra tjetrën: nga njëra anë radikalizmi dhe fanatizmi luftarak- që nuk e ka për dert edhe vrasjen e njerëzve të pafajshëm në rrugë po edhe nëse i takojnë religjionit të njëjtë, ndërsa nga ana tjetër neglizhenca fetare si dhe besimi sinkretist herë pas here i stolisur me ezoterizmin dhe okultizmin misterioz.

Është fakt se shoqëria e sotme rruzullin e orienton në bazë të ritmit të shpenzimit. Zoti kryesisht është një Fuqi, dikund jashtë, i mënjanuar jashtë saj. Ndërsa teologët dhe teorikët e religjionit më tepër merren me dogmën dhe folklorin fetar se sa me urtinë fetare, më tepër me parimet e moralizimit shoqëror se sa me shpirtërinë.

Qasja reale religjioze ndaj fesë duhet të jetë e përqëndruar në tri segmente bazë, edhe atë:

- 1.Përfaqësimi intelektual dhe kohor i teologjisë (shkencës mbi parimet besimore).
- 2.Vendënia reale e ortopraktikës (ibadeteve) në shoqërinë bashkëkohore.
- 3.Emocionimi dhe entuziazmi adhurues në përjetimin e fesë.

Njeriu i cili do ta gjejë veten dhe duke gërryer në thellësitë e ndërgjegjes dhe vetëdijes së shëndoshë do të edukojë si duhet unën e tij do të përfitojë një platformë të artë të lumturisë. Do të përfitojë platformën e ëmbël të shijes së besimit dhe nënshtrimit më të Madhit. Do të kuptojë prej fillimit njeriun, gjërat dhe do të njohtohet me komentin metakozmik të tyre. Thënë shkurt do të qëndrojë karshi Realitetit të urtë të ekzistencës.